



REPUBLIKA E KOSOVES / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO			
QEVERIA - VLADA - GOVERNMENT			
MINISTRIA E EKONOMISE MINISTARSTVO EKONOMIJE MINISTRY OF ECONOMY			
Njesia Org. Org. Jedin Org. Unit	06	Nr. Prot. Br. Prot. Prot. No.	5404
Nr. i faqesve Broj stranica No. pages	3	Datum Date	16.08.24
PRISTINE A			NO.1

**Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria-Vlada-Government**

**Ministria e Ekonomisë
Ministarstvo Ekonomije /Ministry of Economy**

Komisioni për shqyrtimin e kërkesave për regjistrim në regjistrin e ofruesve të shërbimeve të identifikimit elektronik

**Nr.01/2024
Datë:16.08.2024**

Bazuar në nenin 12 të Ligjit Nr.08/L-022 për Identifikimin elektronik dhe shërbimet e besuara në transaksionet elektronike, dhe nenit 6 të Rregullores (ME) Nr.05/2022 për regjistrimin e ofruesve të shërbimeve të identifikimit elektronik, mënyra e paraqitjes së kërkesës, dokumentacioni i nevojshëm dhe mënyra e publikimit të dhënave, Komisioni në takimin e mbajtur me datë 16.08.2024 nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Miratohet Kërkesa e datës 21 qershor 2024 e kompanisë „Evrotrust Technologies AD” (verzioni në anglisht: Evrotrust Technologies JSC) si ofrues i kualifikuar i shërbimit të besuar me seli në Sofje-Bullgari (<https://www.evrotrust.com>), për regjistrim në regjistrin e ofruesve të shërbimeve të identifikimit elektronik dhe skemave të identifikimit elektronik në Kosovë.

2. Kompania „Evrotrust Technologies AD” mund të ofroj këto shërbime në Kosovë:

- identifikimin elektronik;
- certifikata të kualifikuara për nënshkrime elektronike;
- certifikata të kualifikuara për vula elektronike;
- Certifikata të kualifikuar për autentifikimin e faqes së internetit

3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Komisioni ka shqyrtuar kërkesën e parashtruar nga kompania „Evrotrust Technologies AD” për regjistrim në Regjistrin e ofruesve të shërbimeve të identifikimit elektronik dhe skemave të identifikimit elektronik në Republikën e Kosovës. Komisioni ka trajtuar dokumentacionin e bashkëngjitur- fajlli i transferuar si:

- a) Formulari 1- Kërkesa për regjistrim në regjistrin e ofruesve të shërbimeve të identifikimit elektronik dhe skemave të identifikimit elektronik (e plotësuar dhe e nënshkruar) dhe dokumentet e kërkuara në këtë formular:
 - 1) Kushtet e përgjithshme për ofrimin e shërbimeve - dokumenti 1.1;
 - 2) Politika e ofrimit të shërbimeve - dokumentet 2.1- 2.16;
 - 3) Deklarata mbi përvojën në ofrimin e shërbimeve të kualifikuara -dokumentet 3.1- 3. 2;
 - 4) Politika e Mbrojtjes së Privatësisë në pajtim me Ligjin dhe aktet nënligjore nga fusha e mbrojtjes së të dhënave personale - dokumentet 4.1-4.2;
 - 5) Dokumenti mbi strukturën organizative të ofruesit të shërbimit - dokumenti 5.1 ;
 - 6) Dëshmia dhe/ose deklarata për pajtueshmërinë me kërkesat e referuara dhe kushteve të seksioneve 2.4.3, 2.4.4, 2.4.5; 2.4.6 të Rregullores Nr.03/2022 mbi Skemat e Identifikimit Elektronik për Nivele të Caktuara të Sigurisë - dokumenti 6.1;
 - 7) Dëshmia e pagesës së obligimeve administrative, në përputhje me Ligjin për obligimet administrative(N/A);
 - 8) Të tjera –certifikatat - dokumentet 8.1-8.15.

Formulari 3- Deklarata e plotësuar dhe nënshkruar.


Kompania „ Evrotrust Technologies AD është e Regjistruar në Listën e besuar të Komisionit European (eIDAS Dashboard (europa.eu) si „Kompani e kualifikuar e shërbimit të besuar “, që nënkupton se i ka përmbushur procedurat e verifikimit të një Organi valid për Vlerësimin e Konformitetit, që janë të barasvlershme me plotësimin e kërkesave sipas Rregullores (ME) Nr. 10/2022 për vlerësimin e konformitetit të ofruesve të kualifikuar të shërbimeve të besuara dhe shërbimeve të besuara të kualifikuara si dhe sigurimi nga rreziku dhe dëmet e shkaktuara nga ofrimi i shërbimit të besuar të kualifikuar. Po ashtu , sipas Nenit 17 të kësaj Rregulloreje „shërbimi i besuar i kualifikuar i cili ofrohet nga një ofrues i kualifikuar i shërbimit të besuar i themeluar në një nga vendet anëtare të BE-së, konsiderohet i barasvlershëm me shërbimin e besuar të kualifikuar që ofrohet nga një Ofrues i kualifikuar i shërbimit të besuar të themeluara brenda territorit të Republikës së Kosovës”.

Kompania Evrotrust Technologies AD i nënshtrohet çdo dy vjet auditimit nga organet e vlerësimit të konformitetit të akredituar në një shtet anëtar të Bashkimit European, detyrim që e përmbush kërkesën në paragrafin 2 të nenit 24 të Ligjit Nr. 08/L - 022 për identifikimin elektronik dhe shërbimet e besuara në transaksionet elektronik).

Sa i përket kërkesës sipas paragrafit 2.6. të Rregullores rreth dëshmisë për pagesën e tarifës administrative, bazuar në opinionin e Departamentit për Buxhet dhe Financa në ME, Komisioni ka vlerësuar se meqenëse Rregullorja në fuqi nuk ka përcaktuar një çmim rreth dëshmisë së pagesës së obligimeve administrative si e tillë nuk mund të bëjë adresim të të hyrave pa pasur një çmim.

Komisioni në përbërje:

1. Agim Kukaj



2. Deniza Krasniqi



3. Gani Ademi



Iu dërgohet:

- Komisionit;
- Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm;
- Divizionit për Komunikim me Publikun;
- Arkivit.